



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201700449/2

Tiranë ___/___/2017

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative datë 07.09.2015, me paditës R. K. nga Tirana.*

Drejtuar : **Z. KASTRIOT SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijëni : **Z.Raimond KRISTO**
Rr."Fortuzi", Pallati Nr.66 Shk.5, Ap.8

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e tij datë 12.04.2017, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi R. K. nga Tirana ankohet për zvarritje gjykimi pa shkaqe ligjore dhe shkeljen e procedurave gjyqësore nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në lidhje me gjykimin e një çështje administrative e cila ka ardhur për gjykim në Gjykatën tuaj me datë 07.09.2015, dhe rezulton se nga ana juaj, nuk është planifikuar akoma për gjykim.

Ankuesi R. K. nga ana e tij pretendon se në disa raste ka kërkuar me shkrim shpejtim gjykimi dhe përsëri kërkesa e tij nuk kanë gjetur zgjidhje dhe për këto arsye ai i është drejtuar me ankesë institucionit të Avokatit të Popullit, duke kërkuar verifikimin e kësaj çështje gjyqësore, ndërhyrjen e tij me anë rekomandimi për shkeljen e të drejtave të Njeriut, me arsyetim se atij po i cënohet e drejta për një proces të rregullt ligjor.

Nga studimi me kujdes i kësaj ankese rezulton se ankuesi R. K. është larguar padrejtësisht nga puna me datën 25.02.2014 nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Tiranë, dhe kundra vendimit ai është ankuar në Gjykatën Administrative të shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin e saj me Nr.2295 datë 28.04.2015, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë së paditësit R. K.

Anullimin e veprimt administrativ të pales së paditur për kalim të paditësit në listë pritje, të pasqyruar në shkresën nr.643/1 datë 25.02.2014 dhe të DAP të pasqyruar në shkresën me nr.534/1 datë 25.02.2014. Detyrimin e pales së paditur Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës të ripozicionojë paditësin R. K. në shërbimin civil në vendin e tij të punës. Ndaj këtij vendimi është ankuar DAP Tiranë dhe dosja nga data 07.09.2015 ndodhet për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me Relatore Zj.Enkeleda Metaliaj pa u planifikuar për gjykim.

Duke analizuar në tërësi ankesën e shtetasit R. K. rezulton se ai tani ndodhet pa punë dhe nuk merr page nga lista e pritjes jo për faj të tij dhe kohën e ardhjes së dosjes

për gjykim në Gjykatë me datë 07.09.2015, mendohet se në rastin konkret ka vend të ndërhyhet me rekomandim për marrjen e masave për planifikimin dhe shpejtimin e këtij gjykimi duke patur parasysh këto kërkesa :

Neni 3 i Ligjit nr.49/2012 dt.03.05.2012”Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative ka përcaktuar ndër parimet e gjykimit administrativ edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qënë edhe qëllimi i ligjvënësist në krijimin e këtyre gjykatave se ligji synon thejstimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtat e subjektive dhe i interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shejta e të arsyeshme.

Në nenin 48/2 të Ligji nr.49/2012 parashikohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditësh nga dita e ardhjes së ankimit nga Gjykata kur është paraqitur ankimi.

Në këto kushte dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 63/3 të Kushtetutës të RSH ku thuhet se:”Avokati i Popullit, ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të Njeriut, nga adminsitrata publike, dhe neni 21/b të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, ju

REKOMANDOJMË :

1,Marrjen e masave organizative për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative të shtetasit R. K.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj për zbatimin e këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI